

KONVENTA MBI TË DREJTAT POLITIKE TË GRAVE

Hyri në fuqi në vitin 1954

Palët kontraktuese,

Duke dëshiruar të zbatojnë parimin e barazisë të drejtave për burrat dhe gratë të përfshirë në Kartën e Kombeve të Bashkuara,

Duke pranuar që çdo njëri ka të drejtën të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht, dhe ka të drejtën për akses të barabartë në shërbimin publik në vendin e tij, dhe duke dëshiruar për të barazuar statusin e burrave dhe grave në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave politike, në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut,

Kanë vendosur të hartojnë një Konventë për këtë qëllim,

Në këtë mënyrë bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Gratë kanë të drejtën për të votuar në të gjitha zgjedhjet në kushte të barabarta me burrat dhe pa ndonjë diskriminim.

Neni 2

Gratë kanë të drejtën për tu zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publike, të krijuar nga legjislacioni kombëtar, në kushte të barabarta me burrat dhe pa diskriminim.

Neni 3

Gratë kanë të drejtën për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike, të krijuara nga legjislacioni kombëtar, në kushte të barabarta me burrat dhe pa diskriminim.

Neni 4

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në emër të çdo anëtari të Kombeve të Bashkuara dhe, gjithashtu, në emër të çdo shteti tjetër tek i cili Asambleja e Përgjithshme ka paraqitur një ftesë.

2. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 5

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderimin e të gjitha shteteve, referuar paragrafit I të nenit IV.

2. Aderimi do të ketë efekt me depozitimin e instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 6

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit apo aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon apo aderon në Konventë, pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit apo aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit nga ana e këtij shteti të instrumentit të ratifikimit apo aderimit.

Neni 7

Nëse një shtet paraqet një rezervë për ndonjë nga nenet e kësaj Konvente në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo aderimit, Sekretari i Përgjithshëm do të transmetojë tekstin e kësaj rezerve tek të gjithë shtetet të cilët janë ose mund të bëhen palë të kësaj Konvente. Çdo shtet i cili ka kundërshti në lidhje me rezervën e bërë mund të njoftojë, brenda një periudhe prej nëntëdhjetë ditësh nga data e komunikimit në fjalë (ose nga data e anëtarësimit në Konventë), Sekretarin e Përgjithshëm që ai nuk e pranon këtë rezervë. Në një rast të tillë, Konventa nuk do të hyjë në fuqi ndërmjet këtij shteti dhe shtetit që ka bërë rezervën.

Neni 8

1. Çdo shtet mund të denoncojë këtë Konventë nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të ketë efekt një vit nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Kjo Konventë do të pushojë së qeni në fuqi nga data kur denoncimi e redukton numrin e palëve në më pak se gjashtë.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje e cila mund të ndodhë ndërmjet dy ose më shumë shteteve kontraktuese në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk është zgjidhur me negociata, me kërkesën e secilës nga palët në mosmarrëveshje, do të

paraqitet pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për marrjen e një vendimi, në rast se palët nuk kanë rënë dakord për ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet jo-anëtare, parashikuar në paragrafin I të nenit IV të kësaj Konvente, përsa i përket:

- a. Nënshkrimeve dhe instrumenteve të ratifikimit të marra në përputhje me nenin IV;
- b. Instrumenteve të aderimit të marra në përputhje me nenin V;
- c. Datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin VI;
- d. Komunikimeve dhe njoftimeve të marra në përputhje me nenin VII;
- e. Njoftimeve të denoncimit të marrë në përputhje me paragrafin I të nenit VIII;
- f. Shfuqizimit në përputhje me paragrafin 2 të nenit VIII.

Neni 11

1. Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhën kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle do të jenë njëlloj autentike, do të depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të transmetojë një kopje të certifikuar tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe tek shtetet jo-anëtare, parashikuar në paragrafin I të nenit IV.